



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.254, datë 12.11.2019

PËR KUALIFIKIMIN PËR EMËRIM TË KANDIDATIT Z. {...}, I DIPLOMUAR PËR MAGJISTRAT NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 12.11.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për emërimin e tij si gjyqtar,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ai përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2018-2019, përcjell nga Shkolla e Magjistraturës me Shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3596 prot., datë 03.07.2019.

2. Me Vendimin nr.103, datë 05.07.2019, mbështetur në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në përfundim të vitit akademik 2018-2019, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për

procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relator u caktua z.Alban Toro.

3. Më datë 05.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 08.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati z. {...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.07.2019, kandidatit z. {...}, në rrugë elektronike, iu kërkuan të dhëna mbi punësimin/et e tij, të dhëna këto që u dërguan nga kandidati, në rrugë elektronike, brenda të njëjtës ditë.

8. Më datë 10.07.2019, pas marrjes nga kandidati të dhënat e punësimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, u kërkuar informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, subjektet të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionin e tyre në periudha të ndryshme kohore. (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, në datat 10.07.2019, 11.07.2019, 29.07.2019 dhe 29.07.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u

kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, u konstatua se në të mungonin vetëdeklarimet e kandidatit në lidhje me tre prej kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Konkretisht mungonin vetëdeklarimet në lidhje me anëtarësinë në parti politike, me disiplinën në punë (qenien ose jo i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe për pasjen ose jo masë disiplinore në fuqi), si dhe me qenien ose jo bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë, me datë 07.10.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët e vetëdeklarimeve që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

12. Brenda afatit tregues, kandidati z. {...} depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët përkatës të vetëdeklarimeve si dhe dokumente shtese lidhur me shpjegimet për vetëdeklarimin e depozituar në lidhje me marrëdhëniet e punësimit dhe masat disiplinore.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTIN DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI GJYQTAR

A. Për kushtin e emërimit si gjyqtar

1. Sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës¹ së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit të Statusit², për t'u emëruar gjyqtar kërkohet përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe diplomimi.

2. Bazuar në Vendimin nr.3, datë 01.07.2019, të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, përcjell me Shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, si dhe dokumentacionin e kandidatit {...}, përcjell me Shkresën nr.635 prot., datë 04.07.2019, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati në fjalë ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e

¹ “1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, **pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës** dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”.

² “1. **I diplomuari** emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kriteret: ...”

Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2016 - Qershor 2019 dhe është diplomuar për magjistrat, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2018 - 2019.

B. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit

1. Kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit, përcaktohen si kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sikundër po ashtu, sipas neneve 64 dhe 66 të këtij ligji, ato përcaktohen edhe si kriteret zgjedhshmërie, pra si kriteret që magjistrati (gjyqtari) do të duhet t'i plotësojë gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit.

2. Verifikimi në këtë rast i kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit merr shkas nga fakti se kandidati z. {...} është pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të Statusit, por edhe të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përmes të cilëve kanë pësuar ndryshime kriteret dhe rregullat e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, me tej, edhe ato për emërimin e të diplomuarve në këtë shkollë për magjistratë.

3. Gjithsesi, në respektim të parimit të sigurisë juridike, në lidhje me verifikimin e kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, u mbajt në konsideratë ligji i kohës së pranimit të kandidatit z. {...} në programimin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra Ligji nr.8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullorja e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dalë në zbatim të këtij ligji. Po ashtu u mbajt në konsideratë edhe ligji aktual në fuqi, pra Ligji i Statusit. Konsiderimi në këtë rast i rregullimeve sipas këtyre dy ligjeve konsiston në atë se vetëm për kriteret që nuk ka ndonjë përcaktim konkret në ligjin e kohës së pranimit në formimin fillestar, kandidati do të duhet të përmbush këto kriteret sipas ligjit aktual në fuqi.

4. Konkretisht, për kandidatin {...} u verifikuan këto kriteret:

a) zotësia e plotë për të vepruar. Për këtë kriter, ndërsa është verifikuar edhe në momentin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) shtetësia shqiptare. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 05.05.2019 ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 16.10.2019 në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës

personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *arsimimi*. Për këtë kriter, në rastin e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentet: “Diplomë në Juridik”, me nr. 477, datë 03.07.2006, lëshuar nga “Universiteti Luigj Gurakuqi” Shkodër Fakulteti i Drejtësisë; Certifikatë Notash datë 03.07.2006, lëshuar nga “Universiteti Luigj Gurakuqi” Shkodër Fakulteti i Drejtësisë; Vlen të theksohet se për këtë kriter mbahet në konsideratë verifikimi i bërë nga Shkolla e Magjistraturës në momentin e pranimit në provimin e pranimit për në formimin fillestar, sipas përcaktimeve të ligjit të kohës, pra sipas Ligjit nr.8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”;

ç) *gjendja gjyqësore*. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 22.09.2016. Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr.V-2531/1 prot., datë 05.08.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

d) *disiplina në punë*. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas informacionit të marrë nga kandidati, më datë 09.07.2019, u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër. Sipas Shkresës nr.4688/1 prot., datë 22.07.2019, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 16.01.2007-10.08.2007 në detyrë “Specialist”, dhe është larguar nga puna me dëshirën e tij dhe se nuk ka pasur masa disiplinore. Prej kandidatit u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Agjencisë Rajonale të Kthim Kompensimit të Pronave Dibër. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Dibër me Shkresën nr.5312/1 prot., datë 26.08.2019 dhe Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH, Tiranë, me Shkresën nr.7785 prot., datë 13.08.2019, rezulton se kandidati {...} ka qenë i punësuar pranë Agjencisë Rajonale të Kthim Kompensimit të Pronave Dibër dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Gusht 2007- Dhjetor 2009. Sipas Shkresës nr.8753/1 prot., datë 29.07.2019, të Agjencisë Rajonale të Kthim Kompensimit të Pronave Dibër informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 10.08.2007-10.12.2009 në detyrë “Specialist në Sektorin Juridik”, ndërsa është larguar nga puna në bazë të urdhërit të lëshuar nga institucioni dhe se nuk ka pasur masa disiplinore. Prej kandidatit u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.5055/1 prot., datë 17.07.2019, rezulton se kandidati {...} ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Janar 2012- Shtator 2012. Sipas Shkresës nr.2452/1 prot., datë 18.07.2019, Drejtorisë

Rajonale Tatimore Dibër informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 01.01.2012-08.10.2012 ne detyrën “Specialist”, me kontratë të përkohshëm, ndërsa është larguar nga puna me dëshirën e tij dhe se nuk ka pasur masa disiplinore. Me tej kandidati u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.5055/1 prot., datë 17.07.2019, rezulton se kandidati {...} ka qenë i punësuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Tetor 2012- Mars 2014. Sipas Shkresës nr.294/1 prot., datë 25.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 02.10.2012-17.02.2014 ne detyrën “Kancelar”, ndërsa është larguar nga puna sipas urdhërit të Ministrisë të Drejtësisë nr.110 datë 17.02.2014³ dhe se nuk ka pasur masa disiplinore. Në vazhdim prej kandidatit u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Këshilli i Qarkut Dibër. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.5055/1 prot., datë 17.07.2019, rezulton se kandidati {...} ka qenë i punësuar pranë Këshilli i Qarkut Dibër dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Maj 2014- Dhjetor 2014. Sipas Shkresës nr.319/1 prot., datë 16.07.2019 të Këshillit të Qarkut Dibër informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 05.02.2014-31.12.2014 ne detyrën “Specialist për prokurimet”, për një periudhë të përkohshme ndërsa është larguar nga puna për arsye shkurtimesh të pozicionit të punës dhe se për të nuk ka pasur masa disiplinore në fuqi. Së fundi kandidati konstatoi se ai ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Rrugëve Rurale Dibër. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.5055/1 prot., datë 17.07.2019, rezulton se kandidati {...} ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Rrugëve Rurale Dibër dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Mars 2015- Tetor 2015. Sipas Shkresës nr.319/3 prot., datë 319/3 të Këshilli i Qarkut Dibër⁴ informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 03.03.2015-12.10.2015 ne detyrën “Jurist”, ndërsa është larguar nga puna sipas shkresës nr. 170 prot., të DRRRD⁵.

dh) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk është anëtar i

³ Nga ana e kandidatit për Urdhrin e Ministrisë të Drejtësisë të sipërcituar është paraqitur ankimi ne Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe për të është marrë një vendim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë nr. 1472 datë 01.06.2016.

⁴ Drejtoria Rajonale e Rrugëve Rurale Dibër ka qenë ndërmarrje në varësi të Këshillit të Qarkut Dibër me VKM nr. 915 datë 11.11.2015 dhe ndërmarrja është shkrire dhe ka kaluar në varësi të bashkive të qarkut.

⁵ Nga ana e kandidatit për shkresën nr. 170 prot., datë 12.10.2015 të sipërcituar është paraqitur ankimi ne Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe për të është marrë një vendim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë nr. 3176 datë 18.09.2018.

ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit anëtar i ndonjë partie politike;

e) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Për këtë kriter u mbajt në konsideratë mosha e kandidatit (i datëlindjes 27.09.1982), çka bën të panevojshëm verifikimin e këtij kriteri pranë autoritetit të ngarkuar nga ligji (Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit), sikurse përcaktohet edhe në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019:

ë) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk ka qenë dhe nuk është bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

5. Sa i përket kriterit të *përvojës profesionale aktive me kohë të plotë, të paktën tre vjet*, sipas shkronjës “ç”, të nenit 28, të Ligjit të Statusit, ky kriter është i pa aplikueshëm për këtë kandidat për shkak se nuk ka qenë kriter ligjor në kohën e kandidimit për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që kandidati ka përfunduar programin e formimit fillestar dhe është diplomuar tashmë.

B. Për kriterin e pasurisë

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 56/26 prot., datë 18.09.2019.

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;

b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

- c) *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *ka kryer veprime fiktive dhe deklarim të rremë;*
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.3 Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (Kreu IX, Seksioni A, pika 11, shkronja “b”), Këshilli fton kandidatin të paraqis shpjegime dhe dokumente mbështetës në lidhje me Raportin e Kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë përparitur nga ILDKPKI-ja, me anë të komunikimit elektronik më datë 20.09.2019.

2.3.1 Më datë 24.09.2019 kandidati {...}ka paraqitur pranë Këshillit kundërshtimet lidhur me raportin e ILDKPKI-së. Këshilli me shkresë nr. 3675/3 datë 26.09.2019 ka paraqitur pranë ILDKPKI-së kërkesën për rivlerësim të dokumenteve ligjore të dërguara z, {...}.

2.3.2 Më datë 14.10.2019 ILDKPKI ka dërguar raportin me nr. 56/27 prot , nga kjo e fundit janë kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruar nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- c) *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *ka kryer veprime fiktive dhe deklarim të rremë;*
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

2.3.3 Bazuar në raportin e ri dërguar nga ILDKPKI-ja Këshilli njoftoi për gjetje në procedurën e verifikimit të pasurisë, me Vendim të datës 16.10.2019, kandidatin {...}duke i parashtruar përfundimet e kontrollit nga ILDKPKI-ja dhe e ftoi të paraqes shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit tuaj brenda një periudhe 5 ditore.

2.4 Bazuar në njoftimin dhe vendimin e datës 16.10.2019 të Këshilli, për kandidatin {...} në lidhje me rivlerësimin e verifikimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja, më datë 18.10.2019 kandidati parashtrroi kundërshtimet e gjetjeve.

2.5 Bazuar në aktet që janë depozituar në dosjen e kandidatit Këshilli vlerëson kriteret e kandidimit për magistrat te përcaktuara nga dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore te nxjerra ne pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku, në mënyrë që kandidati të vijojë procedurën e emërimit parashikuar nga neni 35 dhe 37 e vijues i Ligjit te sipërcituar. Këshilli i Lartë Gjyqësorë, duke u mbështetur në dispozitat Kushtetuese, ligjin specifik dhe nënligjorë të zbatueshme për çështjen në shqyrtim si edhe pasi shqyrtoi aktet që janë të depozituar në dosjen personale të kandidatit për magistratin {...}, vlerëson se ky i fundit kualifikohet për emërim magistrat duke parashtruar arsyetimin si më poshtë.

2.5.1 Bazuar në raportin e ri dërguar nga ILDKPKI-ja më datë 14.10.2019 nr. 56/27 prot, kjo e fundit pasi ka kryer kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit {...}mbështetur në sqarimet me shkrim dhe dokumentacionet e paraqitura nga kandidati dhe kërkesës së Këshillit për trajtimin e informacionit shtesë parashtron këto gjetje;

- *Kontrata e Shitblerjes nr.925rep nr.177/2 kol datë 25.01.2013 për blerjen e apartamentit me sip. 59.4 m2 në vlerën 3.680.000 lekë është fiktive dhe e bërë me qëllim regjistrimin e apartamentin në hipotekë në emër të palës blerëse me qëllim vendosjen më vonë si kolateral në favor të bankës ku do të disbursohet kredia;*
- *Deklarimi se si burim financiar për blerjen e apartamentit ka shërbyer dhe kredia e marrë është i rremë, pasi rezulton se kredia është disbursuar rreth 17 ditë më vonë ndërsa kontrata e shitblerjes datë 25.01.2013 citon se vlera prej 3.680.000 lekë është shlyer totalisht; gjithashtu ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e kryer;*
- *Është i dyshimtë deklarimi i gjendjes cash në shumën 2.500.000 ndërkohë që subjekti në të njëjtën periudhë ka pasur dhe marrëdhënie kredie;*
- *Subjekti në deklaratën e interesave private Periodike Vjetore 2012 nuk ka deklaruar burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me vlerë 3.680.000 lekë (te formati i detyrimeve ka deklaruar kredi në shumën 2.680.000 lekë;*
- *Për herë të parë , subjekti deklaron në deklaratën e kandidimit se 1.100.00 lekë janë paguar nga kursimet, nga viti 2007-2012, nga të ardhurat familjare (paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes së tij), por në deklaratën e interesave private Periodike Vjetore 2012, nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes cash;*
- *Mos deklarim në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës 2012”, të takës arë me sipërfaqe 2125m2 Pjeçë, Njësia Administrative Melan , Rrethi Dibër, fituar pronësia më datë 1.03.2016;*
- *Rezulton se Subjekti nuk ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2013”.*

Në një konkluzion të tillë, ILDKPKI^a, në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt. 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, ka konkluduar si pasojë e deklaratës së dorëzuar në dt. 23.7.2019 nga kandidati i cili ka deklaruar:

“..Omissis..... 1.Apartament banimi me sipërfaqe 59.4 m2, lagjja “Aksioni”, pallati nr. 29, shkalla nr. 2, kati nr. 2, apartament nr. 4, Peshkopi, blerë më datë 25.1.2013. Vlera 3.680.000 lekë. Zotëron 100% me b/shorten.

2.Tokë arë, me sipërfaqe 7093 m2, Fshati Pjeçë, Njësia Administrative Melan, Rrethi Dibër, fituar sipas ligjit nr.7501. Sipas VKM-së Nr.89, datë 3.2.2016, çmimi rezulton 815.695 lekë. zotëron 100%.

3.Tokë arë me sipërfaqe 2125 m2, Njësia Administrative Melan, Rrethi Dibër, fituar sipas ligjit nr. 7501. Sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, çmimi rezulton 244.375 lekë. zotëron 100%.

4, Llogari bankare në Raiffeisen Bank me nr. 0001097454, me gjendje më 18.7.2019 në shumën 40.204 lekë. zotëron 100%.

5.Gjendje cash në shumën 200.000 lekë. B/shortoja zotëron 100%.

6.Llogari bankare në Credins Bank me nr. 00000744817 me gjendje më 16.7.2019 në vlerën 820 lekë. B/shortja zotëron 100%.

7.Kredi bankare në BKT në emër të {...}në vlerën 2.580.000 lekë. Shuma e detyrimit të mbetur 2.099.411 lekë“ ..Omissis.....

a) Referuar deklaramit të pasurisë, **“për apartament banimi me sipërfaqe 59.4 m2, lagjja “Aksioni”, pallati nr. 29, shkalla nr. 2, kati nr. 2, apartament nr. 4, Peshkopi, blerë më datë 25.1.2013. Vlera 3.680.000 lekë me burim krijimi Kredi BKT, shuma 2.580.000 lekë dhe 1.100.000 lekë nga kursimet, nga viti 2007-2012, nga të ardhurat familjare (paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes së tij” si dhe “burim financiar për blerjen e apartamentit ka shërbyer dhe kredia e marrë është i rremë, pasi rezulton se kredia është disbursuar rreth 17 ditë më vonë ndërsa kontrata e shitblerjes datë 25.01.2013 citon se vlera prej 3.680.00 lekë është shlyer totalisht; gjithashtu ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e kryer”** ka depozituar në deklaratë dokumentet si më poshtë; *..Omissis.....Kontratë premtim shitje nr. 9946 rep., nr. 2013/1 kol, datë 12.12.2012, për blerjen e apartamentit me sip. 59.4 m2, lagja “‘Aksioni””, në qytetin e Peshkopisë, pallati nr. 29, shkalla 2, kati 2, apartamenti nr. 4. Vlera 3.680.000 lekë, nga të cilat 1.100.000 lekë janë likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa shuma e mbetur në vlerën 2.580.000 lekë do të likuidohet nga {...}me disburisimin e kredisë në BKT, Peshkopi. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. 185235, për pasurinë apartament nr. 14/164+2-4, Zona Kadastrale 2932, vol.24, faqe 79, me sip.59.4 m2, në Peshkopi, në pronësi të shtetasve {...}dhe {...}, data e lëshimit 13.1.2009. Kartelë pasurie për apartament me sip. 59.4 m2, në Peshkopi, në pronësi të {...}. Hartë treguese e regjistrimit të apartamentit me sip. 59.4 m2, në Peshkopi. Planimetri e apartamentit të Latif Alku. Akt-noterial, kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr.925 rep., nr.177/2 kol, datë 25.1.2013 për blerjen e pasurisë të llojit apartament me sip. 59.4 m2, në Peshkopi, nga {...}me palë shitëse {...}. Vlera 3.680.000 lekë,*

shumë e cila është likuiduar plotësisht nga ana e blerësve në adresë të shitësve jashtë zyrës noteriale. Planimetri e apartamentit të {...}, në lagjen "Aksioni", Peshkopi. Kontratë kredie bankare nr. 1153 rep., nr. 240 kol, datë 5.2.2013, për marrjen e kredisë në BKT nga ana e {...} në shumën 2.580.000 lekë, për blerje apartamenti. Aneksi i çeljes dhe përdorimit të kredisë, datë 5.2.2013 në BKT. Aneksi i elementeve specifike të kredisë, datë 5.2.2013 në BKT. Ekstrakt i llogarisë në BKT në emër të {...}, ku figuron se në datë 11.2.2013 është disbursuar kredia në shumën 2.580.000 lekë dhe në dt. 12.2.2013 debitohet llogaria në këtë shumë me përshkrimin "likuidim pre blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë nr. 1153/24/rep/kol, dt. 5.2.2013, në favor të shtetasve {...}. Aneks i planit të pagesave të kredisë për vitin 2019. Kontratë hipotekimi nr. 1154 rep., nr. 241 kol., datë 5.2.2013 për hipotekimin e apartamentit me sip. 59.4 m2, me barrë hipotekore në favor të BKT.

Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr.14/164+2-4, ZK nr.2932, Vol.24, Faqe 79, lloji i pasurisë apartament me sip.59.4 m2, në pronësi të {...}, data e lëshimit 29.1.2013. ..Omissis.....

a.1) Nga tërësia e dokumentacionit të administruar, vlerësuar në raport me të dhënat e deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike të vitit 2013 dhe deklaratën e pasurisë plotësuar në vitin 2019, vlerësuar në tërësi, rezulton se :

Subjekti deklarues ka në pronësi banesën me nr. 14/164+2-4, ZK nr.2932, Vol.24, Faqe 79, me sip.59.4 m2 regjistruar në regjistrat e pasurive te paluajtshme të cilën e posedon prej vitit 2013 kur është realizuar kontrata e shitblerjes dhe deri aktualisht. Lidhur me mënyrën e pagesës së vlerës së kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të ardhurave për pagesën përkatëse, subjekti deklaron se ka paguar shumën prej 1.100.000 në momentin e lidhjes së kontratës për premtim shitje, me date 12.12.2012 dhe shumën prej 2.580.000 me burim kredinë hipotekore të marrë pranë BKT. Sa i përket pagesës së këstit të parë prej 1.100.000 lekë ILDKPKI, ne raport konkludon se kjo shumë është krijuar nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes nga paga për periudhën 2007-2012 dhe nuk rezulton të ketë dyshime për burimin e krijimit dhe aftësitë e subjektit për të kursyer këtë shumë deri në momentin e kryerjes së pagesës së këstit të parë më datë 12.12.2012. Ky fakt, shlyerja e këstit të parë në datë 12.12.2012 rezulton nga përmbajtja e kontratës premtim shitje me nr. 9946 rep nr. 2013/1 kol datë 12.12.2012 në të cilën palët kontraktore kanë deklaruar para noterit, ndër të tjera se :*"Premtuesit {...} kanë rënë dakord që këtë pasuri , apartament t'ia shesin premtues blerësit {...}kundrejt çmimit të përcaktuar ndërmjet tyre në shumën 3.680.000 lekë, "...vlerë e cila, sipas deklaramit të palëve para meje, është likuiduar në shumën 1.100.000 lekë, sot në datën e redaktimit të kësaj kontratë..."*, ndërsa shuma e mbetur me vlerë 2.580.000 lekë në marrëveshje mes palëve është vendosur që të likuidohet plotësisht nga ana e premtues blerësit {...} me disbursimin e një kredie bankare në adresë të tij.."

Lidhur me shlyerjen e këstit të dytë në vlerën 2.580.000 lekë rezulton e provuar se kjo shumë, disbursuar për shkak të kontratës së kredisë në llogarinë e subjektit në datë 11.02.2013 dhe më datë 12.02.2013 llogaria debitohet me përshkrimin "likuidim blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë nr. 1153/24/rep/kol, dt. 5.2.2013, në favor të shtetasve {...}." Rezulton e provuar që shuma përkatëse buron nga kontrata e kredisë hipotekore lidhur me BKT, dhe është përdorur për të paguar këstin e dytë për blerjen e apartamentit për arsye se :

Së pari subjekti ka aplikuar për kredi me qëllim specifik dhe shume të përcaktuara që përkon tërësisht me detyrimin e mbetur pa paguar për blerjen e apartamentit;

Së dyti, shuma e plotë është kaluar në datë 12.02.2013, nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e subjektit {...} pranë BKT, në llogarinë bankare të shitësve, konkretisht në llogari të shtetasës {...}

Së treti, deklaratimet e subjektit për mënyrën dhe kohën e pagesës së kështit të dytë përputhen me deklaratimet e blerësve {...} në deklaratën noteriale nr. 8508 rep nr. 2544 kol datë 23.09.2019 në të cilën ata deklarojnë se shuma 2.580.000 lekë është kaluar në llogarinë e tyre pas realizimit të kontratës së shitjes. Kontratat bankare në kuptim të kreut XVIII dhe nenit 686 e në vijim janë kontrata në seri të parapërgatitura nga ana e kontraktuesit më të fortë dhe të përfunduara nëpërmjet nënshkrimit nga ana e klientit të gjitha kushteve të përgjithshme të paracaktuara dhe të pa negociueshme nga ana e Bankës. Natyrshëm vullneti i kontraktuesit me të dobët rezultojnë të jetë shumë i kufizuar dhe shpesh herë i ndërvarur nga skema e garancisë e kërkuar nga Banka në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë. Kjo e fundit rregullohet nga neni 1031 nga Kodi Civil e ka përcaktuar këtë kontratë si “një kontratë me të cilën banka detyrohet të mbajë në dispozicion të palës tjetër një shumë parash, për një periudhë të caktuar kohe ose për një kohë të pacaktuar”. Për përfitimin e saj kredi marrësi është i detyruar të zbatojë kushtet e punës të vendosura nga Banka jo vetëm për mënyrën e përgatitjes së fazës paraprake të nënshkrimit të kontratës por edhe në fazat në vijim ku përfshihet disbursimi, rimbursimi dhe garantimi i vlerës monetare të kredisë dhënë nga Banka. Në rastin *de qua* rezultojnë e provuar se Banka Kombëtare Tregtare ka transferuar direkt në llogarinë e shitësve vlerën e kontaktuar të shitjes së pasurisë së paluajtshme duke provuar në këtë mënyrë vërtetësinë e vullnetit të palëve në krijimin e pasojave juridike.

b) Në lidhje me konkluzionet e ILDKPKI së : “Kontrata e Shitblerjes nr.925 rep nr.177/2 kol datë 25.01.2013 për blerjen e apartamentit me sip. 59.4 m2 në vlerën 3.680.000 lekë është fiktive dhe e bërë me qëllim regjistrimin e apartamentin në hipotekë në emër të palës blerëse me qëllim vendosjen më vonë si kolateral në favor të bankës ku do të disbursohet kredia” si dhe “Deklarimi se si burim financiar për blerjen e apartamentit ka shërbyer dhe kredia e marrë është i rremë, pasi rezultojnë se kredia është disbursuar rreth 17 ditë më vonë ndërsa kontrata e shitblerjes datë 25.01.2013 citon se vlera prej 3.680.00 lekë është shlyer totalisht; gjithashtu ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e kryer;

b.1) Këshilli vlerëson se nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk përputhen me faktet dhe rrethanat që burojnë nga dokumentacioni i administruar. Lidhur me veprimet juridike fiktive neni 93 i Kodit Civil parashikon se :” Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.”

Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 932, datë 22.06.2000, shprehet se: “...omissis. Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me

qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundër deklaramit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”

Referuar nenit 93 të Kodit Civil të sipërcituar, veprim fiktiv është veprim juridik që nuk ka për qëllim realizimin e objektit të tij sikurse palët deklarojnë formalisht dhe nuk pasqyron vullnetin real dhe të përbashkët të palëve. Pra, në një veprim juridik fiktiv vullneti i brendshëm i palëve nuk përputhet me vullnetin e shfaqur prej tyre dhe të materializuar në mënyrë formale në kontratë. Fiktiviteti është një ndër të metat e veprimit juridik që pasjellë pavlefshmëri absolute të tij dhe pamundësinë e tij për të sjellë pasoja duke qenë se mungon një ndër elementet thelbësorë të veprimit juridik që është vullneti. Në lidhje me “pasojën” e veprimit juridik fiktiv neni 92 pika 1 shkronja “ ç” parashikohet se :” Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: ... ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).”.

Në rastin konkret kontrata me datë 25.01.2013, nuk rezulton është veprim juridik fiktiv për shkak se rezulton i qartë dhe i vërtetë vullneti i palëve për realizimin e objektit të saj, palët kanë marrë përsipër dhe kanë përmbushur detyrimet reciproke të përcaktuara në këtë kontratë si dhe ka sjellë pasojat e saj pasi pasuria ka kaluar në favor të blerësit dhe shuma ka kaluar në favor të blerësve. Pra rezulton e provuar se kontrata ka përmbushur tërësisht objektin për të cilin është lidhur, ka sjellë të gjitha pasojat e saj dhe për këtë arsye, nuk mund të vlerësohet si një kontratë fiktive, pasi ka përputhje të plote të vullneti të brendshëm të palëve kontraktore dhe vullnetit të shprehur prej tyre nëpërmjet formalizmit në këtë kontratë.

c) Referuar deklaramit të pasurisë **“Është i dyshimtë deklarami i gjendjes cash në shumën 2.500.000 lekë, ndërkohë që subjekti në të njëjtën periudhë ka pasur edhe marrëdhënie kredie”**, sipas te ILDKPKI dhe analizës së pasqyruar në faqen 7 , pasi analizohet gjendja e të ardhurave të subjektit në vitet 2007-2012 si dhe shpenzimet për konsum, është konkluduar se subjekti mund të kursente shumën e deklaruar si gjendje cash në vitin 2012. Pasja e një marrëdhënie kredie siç deklarohet në faqen 5 të deklaramit para fillimit të detyrës në vitin 2012 dhe deklarami njëkohësisht i gjendjes cash në vlerën 2.500.000 lekë nuk është shkak për të krijuar dyshime për vërtetësinë e deklaramit për sa kohë nuk rezultojnë elemente të tjerë që të mbështesin këtë dyshim. Duke qenë se sipas analizës financiare të kryer nga ILDKPKI për vitet 2007-2012 rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mbajtueshme për të bërë të mundur kursimin e shumës së deklaruar dhe burimi i krijimit të tyre rezulton i ligjshëm (nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij) konkluzioni i ILDKPKI lidhur me këtë fakt rezulton i pa bazuar.

ç) Lidhur me konkluzionin e ILDKPKI së :” **Për herë të parë , subjekti deklaroi në deklaramin e kandidimit se 1.100.00 lekë janë paguar nga kursimet, nga viti 2007-2012, nga të ardhurat familjare (paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes së tij), por në deklaramin e interesave private Periodike Vjetore 2012, nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes cash;**”, referuar deklaramit

periodike të vitit 2012 dorëzuar në datë 25.03.2013, deklaratës së plotësuar në vitin 2019 si dhe kontratës së porosisë për blerje apartamenti më datë 12.12.2012, rezultojnë se :

ç.1) Së pari në deklaratën periodike të vitit 2012 rezultojnë se deklaruesi ka pasaktësi në plotësimin e saj pasi rezultojnë se ka deklaruar blerjen e apartamentit të banimit si pasuri të përfshirë në DPV 2012 ndërkohë që blerja e këtij apartamenti ka ndodhur në vitin 2013 dhe duhej të deklarohet në DPV të këtij viti. Gjithashtu rezultojnë se edhe për të ardhurat nga paga subjekti ka bërë deklaram të gabuar pasi, përveçse i ka pasqyruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë dhe jo në rubrikën e të ardhurave, ka vendosur shumën e pagave mujore nga data 02.10.2012 deri në datën e dorëzimit të deklaratës (deklarohet paga mujore për pesë muaj ndërkohë që duhej të deklarohet deri në datë 31.12.2012). Pra rezultojnë se subjekti ka plotësuar me disa pasaktësi DPV të vitit 2012 duke përfshirë në të edhe të ardhurat apo ndryshimet e pasurisë të ndodhura në vitin 2013, deri në datën e dorëzimit të deklaratës.

ç.2) Së dyti, lidhur me mos deklaramin e pakësimit të gjendjes cash në vlerën 1.100.000 lekë për pagesën e këstit të parë të blerjes së apartamentit në datë 12.12.2012 vlerësohet se kjo përbën pasaktësi në plotësimin e deklaratës. Ndërkohë në deklaramin e vitit 2019 subjekti ka përshkruar sakte burimin e krijimit të vlerës për blerjen e apartamentit dhe kohën e kryerjes së pagesave të dy kësteve të tij. Gjithashtu burimi i krijimit të tyre, sipas dokumentacionit dhe konkluzioneve të ILDKPKI ka rezultuar i ligjshëm. Për këtë arsye pasaktësitë në deklaramat vjetore lidhur me deklaramin e të ardhurave ose pasurive, nëse nuk ka dyshime për fshehje ose deklaram të rreme të tyre, vlerësohen në cilësinë e provës në raport me deklaramin e kandidatit të vitit 2019. Gjithashtu në deklaramin e vitit 2019 subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash, çka bën të mendohet se kjo gjendje është konsumuar ose ka shërbyer për shlyerjen e detyrimeve gjatë viteve 2012-2019.

ç.3) Së treti, lidhur me pagesën e këstit të parë të blerjes së apartamentit në masën 1.110.000 lekë, kryerja e kësaj pagese rezultojnë edhe nga kontrata e porosisë me datë 12.12.2012 që specifikon mënyrën e pagesës si dhe shlyerjen e kësaj shume në momentin e lidhjes së kësaj kontrate. Pasaktësia në deklaramin e pakësimit të gjendjes cash në DPV të vitit 2012 në raport me shumën prej 2.500.000 leke cash të deklaruara në deklaramin para fillimit të detyrës në Tetor 2012, nuk mund të përbëjë shkak për të hedhur dyshime mbi vërtetësinë e saj për sa kohë nuk ka asnjë element tjetër që mbështet këtë fakt dhe burimi i krijimit të shumës së deklaruar si kursim, shpenzuar më pas pjesërisht për blerje apartamenti ka rezultuar i ligjshëm.

d) Në lidhje me konkluzionin e ILDKPKI-së: **“Mos deklaram në deklaramin e interesave private “Para fillimit të detyrës 2012”, të takës arë me sipërfaqe 2125m² Pjeçë, Njësia Administrative Melan , Rrethi Dibër, fituar pronësia më datë 1.03.2016;”**, referuar deklaramin të pasurisë, kandidati ka depozituar në deklaramin dokumentet si më poshtë : *Akt noterial nr.1801 rep., nr.88 kol, datë 1.3.2006 për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme të përbashkët “tokë truall”, ku bashkëpronarët {...} deklarojnë se {...} ka marrë në dorëzim këtë sipërfaqe tokë arë 9.218 m²; në këtë mënyrë, me hartimin e këtij akti noterial, nënshkrimin nga bashkëpronarët dhe regjistrimin e këtij akti në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme Dibër, kjo pasuri kalon në pronësi të familjes bujqësore me kryefamiljar {...} për të gjitha efektet ligjore. {...} , në vitin 1991 kanë qenë pjesëtar të një familjeje dhe k/familjar kanë pasur {...} dhe e gjithë pasuria e paluajtshme e kësaj familje, është regjistruar në emër të tij. Certifikatë për vërtetim pronësie për*

pasurinë nr.13/21, ZK 2976, Vol.1, Fq 153, me adresë pasurie në Pjeçë, Dibër, lloji i pasurisë tokë arë me sip.2.125 m2, në pronësi të {...}, data e lëshimit 8.3.2006. Kartelë pasurie për tokë arë me sip.2.125 m2 në Pjeçë, Dibër, në pronësi të {...}.

Sipas aktit përfundimtar të kontrollit nga ILDKPKI deklarim për vitin 2019 përputhet me dokumentacionin e dorëzuar nga ana e kandidatit tek i cili shpjegohet origjina e fitimit të pronës, fillimisht me anë të ligjit Nr.7501, kjo tokë arë është përfituar nga familja bujqësore me përbërje 5 anëtarë, me kryefamiljar {...}, pjesë e së cilës ka qenë edhe deklaruesi. Më pas, pjesëtimi i pasurisë/ndarje nga kjo familje bujqësore me datë 1.3.2006, ku anëtarët e tjerë kanë hequr dorë në favor të deklaruesit. Mos deklarimi i pronës së përfituar si më sipër përbën pasaktësi në plotësimin e deklaratës periodike të vitit 2012 por kjo pasaktësi nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit për sa kohë rezulton se origjina e pronës është e përcaktuar, e ligjshme në burim dhe është deklaruar rregullisht në deklaratën e vitit 2019 është objekt kontrolli dhe vlerësimi në kudër të vlerësimit të kandidatit për efekt të kualifikimit për emërimin si gjyqtar. Duke qenë se kjo pasaktësi është korrigjuar nga subjekti në plotësimin e deklaratës së vitit 2019, mos deklarimi i pasurisë në DPV 2012, siç pranohet dhe nga subjekti gjatë shpjegimeve të dhëna me shkrim, vlerësohet të jetë, **error ad hominem**, gabim njerëzor por nuk mund të vlerësohet si fshehje e pasurisë për sa kohë rezulton deklarimi i rregullt i saj në vitin 2019 dhe origjina e ligjshme e krijimit të saj, për shkak të zbatimit të Ligjit nr.7501 “Për tokën”.

Në përfundim të vlerësimit të akteve të administruara në ligj me pasurinë e kandidatit dhe të konkluzionit se nuk konstatohen probleme me pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësorë është mbështetur edhe në nenin 12 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i cili kërkon zbatimin e njërës prej parimeve nga më të rëndësishëm gjatë nxjerrjes së aktit administrative atë të proporcionalitetit. Parimi i proporcionalitetit qëndron në “ekuilibrimin të drejtë të interesave”, vlerësimi i rëndësishëm dhe objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: (i) objektivi i organit administrativ është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin; e thënë ndryshe ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t’u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*shih vendimin nr.52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Ligji nr. 9049/2003 dhe formularët e deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues/kandidatit të deklarojë në formën e përcaktuar të gjitha pasuritë, asetet dhe të ardhurat e tij me qëllim **prezantimin e një fotografie të interesave të tij pasurorë** e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme duke i dhënë mundësi Institucionit verifikues dhe kontrollues të këtyre deklarimeve të verifikojnë sipas koncepteve të logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues apo konstatohen fshehje të pasurisë apo paligjshmëri në krijimin e saj.

Nga analiza e akteve të administruara nuk konstatohet probleme në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së kandidatit ndërkohë që gabimet e konstatuara në formularin e deklarimit të vitit 2012 janë korrigjuar me pas në atë të vitit 2019 duke konfirmuar se kandidati nuk ka pasur synim të shmangë deklarimin ligjor të pasurisë.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni i dërgua me Shkresën nr. 13610/1 prot., datë 19.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk ka të dhëna për aktivitet tregtarë të regjistruar.

3.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 18232/1 prot., datë 23.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

4. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kandidatit dhe justifikimin ose jo të pasurisë së tij;
- ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklaramit të pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar.

C. Për kriterin e figurës

11. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...} , u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitet të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...} , atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.07.2019, formularin e

vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 2057/82 prot., datë 11.10.2019, Vendimin “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, sipas të cilit është vlerësuar se “*Subjekti deklarues {...} , kandidat për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës⁶, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.2. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 6418/1 prot., datë 04.09.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...} , pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

4.2.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të nënshkuara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;

⁶ *Përcaktim i gabuar nga Institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme sepse referuar shkresës nr.4038 prot., datë 26.07.2019 me lëndë” Kërkesë për Informacion për kandidatet për gjyqtar të diplomuar në shkollën e magjistraturës për vitin akademik 2018-2019”.*

- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) qenien ose jo të kandidatit, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) qenien ose jo të kandidatit, bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

IV. KONKLUSIONE

Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} , Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit për emërim magjistrat, profili gjyqtar.

PËR KETO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 35, pika 1 dhe pika 4, shkronja “a”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori z. Alban Toro,

VENDOSI:

1. Kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magistrat në Shkollën e Magistraturës në vitin akademik 2018 - 2019 dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} , sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR